



STRATEGJIA PËR MËSIMIN SIPËRMARRËS NË REPUBLIKEN E MAQEDONISË 2014-2020

Përgatitur me ndihmën e
Fondacionit Evropian për Trajnim



Shkup, nëntor, 2014



STRATEGJIA PËR MËSIMIN SIPËRMARRËS NË REPUBLIKEN E MAQEDONISË 2014-2020

Përgatitur me ndihmën e
Fondacionit Evropian për Trajnim



Shkup, **1**nëntor 2014

Strategjia për mësim sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë 2014-2020 është e përgatitur me ndihmën e fondacionit Evropian të treningjeve, Torino, Itali. Fondacioni Evropian I treningjeve është agjension I Bashkimit Evropian (BE) e cila u ndihmon shteteve ne tranzicion dhe në zhvillim që të shfrytëzojnë potencialin e kapitalit njerëzor nëpërmjet reformave ne sistemet arsimore, treningjeve dhe tregun e punës në aspekt te politikave të jashtme Evropiane.

PËRMBAJTJA

Falënderim	vii
Shkurtesat	viii
1. HYRJE	1
1.1 Konteksti vendor dhe qëllimi	3
1.2 Lidhjet me strategjitë dhe dokumentet tjera relevante	5
Lidhjet me strategjitë dhe dokumentet kryesore qeveritare	5
Lidhje me dokumentet e BE-së	7
2. VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET KRYESORE	9
2.1 Vizioni i mësimit sipërmarrës	9
2.2 Misioni i mësimit sipërmarrës	9
2.3 Qëllimet kryesore	10
Qëllimet afatgjate (prej 4 deri 6 vite)	10
Qëllimet afatmesme (prej 2 deri 4 vite)	10
Qëllimet afatshkurtër (prej tani deri më 2 vite)	11
3. MËSIMI SIPËRMARRËS SI KOMPETENCË KRYESORE	12
4. AKTORËT dhe përgjegjësitë	16
4.1. Komiteti Drejtues i MS.....	16
4.2. Aktor tjerë kombëtar	18
4.3. Partnerët ndërkombëtar dhe ekspertët:	19
5. SFIDAT	21
6. FUSHAT PRIORITARE	22
6.1 Arsimi fillor dhe parashkollor	24
6.2 Arsimi i mesëm	25
6.3 Universitetet	25
6.4 Arsimi informal dhe joformal.....	26
6.5 Sipërmarrësit	27
7. QËLLIMET DHE HARTA	28
7.1 Qëllimet afatgjate: 2018 - 2020	28
7.2. Qëllimet afatmesme: 2016 - 2018.....	30
7.3. Qëllimet afatshkurtër: 2014 - 2016.....	31
8. NDËRTIMI I NJË MJEDISI TË QËNDRUESHËM PËR MËSIMIN SIPËRMARRËS	32
8.1 Ndikimi i indikatorëve kryesor dhe qëllimeve kryesore (rezultate e pritura, daljet dhe pritjet) ...	33
8.2 Progresi	36
8.3 Vlerësimi.....	36
9. FINANCIMI	37
10. HAPAT VIJUESE	37
11. REFRENCAT	39



D-r Gjorge Ivanov

President i Republikës së Maqedonisë



M-r Vladimir Peshevski

**Zëvendës President i Qeverisë, i ngarkuar për
çështje ekonomike**



M-r Abdilqim Ademi

Ministër i arsimit dhe shkencës



M-r Bekim Neziri

Ministër i Ekonomisë



Dime Spasov

Ministër i punës dhe politikës sociale

Falënderim

Krijimi i çfarëdo dokumenti strategjik në nivelin nacional është një aktivitet përplot me sfida. Gjithashtu, ky dokument trajton një numër të madh sfidash: procesi i ndryshimit të mentalitetit të popullatës (veçanërisht në mesin e të rinjve) çështjet e rënda të papunësisë dhe përmirësimin e mësimit të përjetshëm. Me një fjalë, kjo strategji ka potencialin për të kontribuar mbi prosperitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Këto pritje kërkojnë një strategji me cilësi të lartë, koherente dhe reale.

Strategjia nacionale për mësimin sipërmarrës 2014-2020 është harta për arritjen e kushteve të përmendura më lartë.

Ekipi që zhvilloi dokumentin e strategjisë nacionale për mësimin sipërmarrës ka shprehur falënderim për vizionin e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë të Republikës së Maqedonisë për nisjen e kësaj aventure dhe për udhëheqjen dhe udhëzimin nëpër gjithë procesin gjatë 18 muajve të fundit.

Fondacioni Evropian për Trajnim e morri këtë iniciativë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë dhe me kapacitete të plota (financiare, njohuri dhe ekspertizë) fuqishëm ka mbështetur zhvillimin nëpër gjitha fazat. Falënderim i veçantë jepet për ekipin e ekspertëve të ETF të udhëhequr nga Eduarda Castel Branco, Kristien Van den Eynde, Anthony Gribben dhe Gavril Lasku.

Qendra e Evropës Juglindore për Mësimin Sipërmarrës ka dhënë një kontribut të vlefshëm për zhvillimin e këtij dokumenti strategjik. Falënderojmë edhe gjithë ekipin SEECCEL (z-nja Efka Heder, z-nja Maja Ljubic, z-nja Sonja Segvic dhe z. Igor Nikoloski).

Kishim nderin që disa herë të jemi nikoqir të ekspertëve për ndërmarrje nga Britania Prof. Andy Penaluna dhe Prof. Kathryn Penaluna në Maqedoni. Ata shfrytëzuan një pjesë të përvojës së tyre në Maqedoni për të dhënë informata shumë të rëndësishme për strategjinë. Falënderime të sinqerta për Andy dhe Kath.

Mësimi Sipërmarrës kalon nëpër shumë disiplina. Për këtë shkak kishte nevojë për përfshirje të plotë të një sërë aktorësh, që të fitohet një shqyrtim në të gjitha aspektet e mësimit sipërmarrës. Gjatë gjithë procesit (që përfshin 4 punëtori dhe më shumë se njëqind kontakte të drejtpërdrejta me aktorë të ndryshëm dhe informata kthyesë në Facebook dhe twitter) kishte kontribute të shumta përfshirë pikëpamjet e ndryshme dhe shpesh mendimet e kundërta, dhe kjo pasuroi përgatitjen e strategjisë. Lista e të gjitha palëve të përfshira është tepër e gjatë për ta përfshirë në këtë pjesë, për këtë shkak, këtu ju falënderojmë të gjithëve..

Në fund, ekipi që është përfshirë në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për mësim sipërmarrës shpreh falënderimin më të sinqertë për përkrahjen e plotë gjatë gjithë stadeve të përgatitjes së këtij dokumenti strategjik ndaj:

Presidentit të Republikës së Maqedonisë, z. Gjorgji Ivanov

Zëvendës Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë përgjegjës për çështje ekonomike, z. Vladimir Pesovski,

Ministrit të arsimit dhe shkencës z. Spiro Ristovski,

Ministrit të ekonomisë, z. Valon Saraçini,

Ministrit të punës dhe çështjeve sociale, z. Dime Spasov,

Të gjithë të tjerë që nuk janë përmendur këtu dhe kanë dhënë kontribut të dukshëm në përgatitjen e strategjisë, ju themi një FALEMINDERIT të madhe.

Prof. Dr. Radmil Polenakovik

Dr. Dragan Sutevski

Shkurtesat

QAR	Qendra për Arsimin e të Rriturve
APERM	Agjencia për Promovimin e Sipërmarrjes
BZA	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
QFB	Qendra për Fillimin e Bizneseve
CIRA	Qendra për Zhvillim Institucional
AS	Arsimi sipërmarrës
MS	Mësimi sipërmarrës
APRM	Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnim
BE	Bashkimi Evropian
KZÇE	Kabineti i Zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike
MASSUM	Shoqata Rinore e Shkollave të Larta Teknike në Maqedoni
FMZS	Fondacioni i Maqedonisë për Zhvillimin e Sipërmarrjeve
MK	Maqedonia
ME	Ministria e Ekonomisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MF	Ministria e Financave
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
QNZMIS	Qendra Nationale për Zhvillimin e Mësimin për Inovacion dhe Sipërmarrës
KNIS	Komisioni Nacional për Inovacion dhe Sipërmarrje
KNSK	Këshilli Nacional për Sipërmarrje dhe Konkurrencë
RNES	Rrjeti Nacional i Edukatorëve për Sipërmarrje
OJQ	Organizata Joqeveritare
NPAA	Programi Nacional për Miratimin e të Drejtës Evropiane
SEECCEL	Qendra e Evropës Juglindore për Mësimin Sipërmarrës
APT	Arsimi Profesional dhe Trajnimi
BNJVL	Shoqata e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë

1. HYRJJE

Në fund të vitit 2012, **Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)** ka shprehur interes për të bashkëpunuar me Fondacionin Evropian për Trajnim (ETF) për të zhvilluar strategjinë e parë mbi Mësimin Sipërmarrës në vend. Si përgjigje të kësaj kërkesë, ETF ofroi udhëzim, njohuri të përbashkët dhe praktikë të mirë, ekspertizë teknike dhe sigurim të cilësisë gjatë procesit të plotë të përpilimit të strategjisë. Në dhjetor të vitit 2012, ETF mbështeti organizimin e punëtorisë së parë me një grup të gjerë të aktorëve relevant, përfshirë edhe sipërmarrës të rinj. Punëtorja rezultoi me identifikimin e një numër të shtyllave të cilat do të përshihen gjatë fazës vijuese të diskutimit dhe planifikimit, që në fund të jep një strategji nacionale për mësim sipërmarrës. Punëtorja gjithashtu nënvizoi disa prej parakushteve për zbatim të prioritetëve strategjike. Disa prej këtyre ishin a) udhëheqje të përpjekjeve për reforma nga autoritetet arsimore, b) partneritet me aktoret në eko-sistemin e sipërmarrjes, në veçanti elita afariste dhe c) sigurimi që mësimi sipërmarrës mbështet nevojën dhe mundësitë që jepen nga sipërmarrja.

Një punëtori e dyte ishte organizuar në prill të vitit 2013. Qëllimi i saj ishte të prezantojë aktivitetet e propozuara fillestare për përgatitjen e Strategjisë për Mësim Sipërmarrës për Republikën e Maqedonisë. Gjatë punëtorisë, ekipe ekspertësh prezantuan veten dhe rolet e tyre, pastaj përshkruan konceptin e plotë të projektit dhe rezultatet e planifikuara. Ekspertët gjithashtu prezantuan metodologjinë, qasjen dhe pikat kryesore të cilat do të përdoren për të ndjekur zhvillimin e strategjisë për MS. Punëtorja morri informacione të shkëlqyeshme kthyes nga pjesëmarrësit dhe ide të cilat mund të inkorporohen në zhvillimin e kësaj strategjie.

Gjatë periudhës prej prill deri më qershor 2013, një spektër i gjerë i e-veglave për rrjetëzim ishin zhvilluar për të marrë më tepër informacione. Këto të dhëna kanë plotësuar vizitat e vërteta që kanë zhvilluar ekspertët.

Pas grumbullimit të ideve të ndryshme me anë të veglave të rrjetëzimit dhe vizitave në vend gjatë kësaj periudhe, e përpiluar raportin e inventarizimit të praktikave të mira të cilat i prezantuan gjatë punëtorisë së tretë në korrik të vitit 2013. Dokumenti i fundit të inventarizimit ishte përditësuar me rekomandimet dhe idetë nga pjesëmarrësit e punëtorisë së tretë dhe ka shërbyer si bazë për krijimin e kësaj strategjie për mësimin sipërmarrës.

Pjesëmarrësit e punëtorisë që në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në krijimin e kësaj strategjie kanë qenë përfaqësues nga institucionet kryesore shtetërore, oda ekonomike, organizata të përfaqësuesve të punëdhënësve, organizata për mbështetjen e afarizmit, shkolla fillore dhe të mesme, universitete, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsimin e të Rriturve, QAPT, sipërmarrës të rinj, përfaqësues të donatorëve, komuna dhe institucione tjera relevante.

Sipërmarrja është pranuar të jetë një prej temave më të rëndësishme në një ekonomi bashkëkohore; mirëpo, në kohën e njëjtë është e njohur të jetë edhe një prej lëndëve më të ndërlikuar. Strategjia për Mësimin Sipërmarrës¹ (MS) ka për qëllim të nxit vetëbesimin e njerëzve për biznese sipërmarrëse në mënyrë që do të mundësojë të marrin pjesë të plotë dhe efektive në zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë dhe bashkësisë. Sipërmarrja është një mënyrë e të

¹ Definicioni i mësimin sipërmarrës si dallim mes MS dhe arsimit mbi sipërmarrje është dhënë në pjesën 3 të këtij dokumenti

menduarit dhe sjelljes, për identifikimin e mundësive, përpilimin e ekipit, mbledhjen e resurseve, të qenit pozitiv, marrja e rrezikut dhe krijimin e ardhmërisë.

Posedimi i shkathtësive dhe aspiratave për të udhëhequr një ekonomi të suksesshme që përmban biznese konkurruese dhe inovative që gjenerojnë vende pune me cilësi të mirë dhe prosperitet të qëndrueshëm për gjithë është një prioritet i lartë për gjitha vendet. Në kuptimin praktik, sipërmarrja mund të zbatohet në shumë kontekste të ndryshme ekonomike siç janë sipërmarrja sociale, sipërmarrja e sektorit publik, intra-sipërmarrja, sipërmarrja në industritë kreative dhe shumë kontekste tjera.

Shumë prej shteteve të BE-së akoma nuk kanë strategji për mësimin sipërmarrës, ndonëse ka pasur shumë thirrje dhe raporte nga Komisioni Evropian. Këto theksojnë përfitimet e konsiderueshme të arsimit për sipërmarrje për ekonominë e një vendi dhe popullatën rinore të saj. Disa vende (si Norvegjia, Finlanda, Danimarka, Uells, etj.) vetëm më kanë njohur përfitimet e strategjisë së mësimin sipërmarrës dhe kanë zbatuar me sukses politika për të siguruar që gjithë studentët marrin një formë të arsimit sipërmarrës gjatë viteve të shkollimit të tyre formal. Ndonëse këto vende kanë strategji të qarta në kuptim të arsimit për sipërmarrje, vendet tjera posedojnë një sërë iniciativash të ndara që zhvillohen në nivelet e mesme dhe terciare të arsimit, megjithatë nuk kanë strategji të plotë koherente. Duhet të theksohet që disa prej këtyre vendeve janë akoma në procesin e trajtimit të mungesës, për shembull në Angli, një Grup Parlamentar i Përzier² është themeluar për të bërë propozime politike dhe Departamenti për Inovacion Afarist dhe Shkathtësi vetëm më ka filluar punën në bazë të informacioneve të hershme të gjetura.

Sipas profesorit Thomas Cooney “*Qëllimi kryesor arsimit sipërmarrës nuk është thjeshtë të detyron secilin të fillojë bizneset e tyre por të jep të rinjve mundësinë për të menduar në mënyrë pozitive, të kërkojnë mundësi për të krijuar gjërat, të kanë vetëbesimin për të arritur qëllimet e tyre dhe të përdorin talentin e tyre për të krijuar një shoqëri më të mirë (ekonomike dhe shoqërore). Ajo gjithashtu pohon që nxënësit dhe studentët e gjitha lëndëve akademike mund të bëhen pjesë e këtij procesi dhe që suksesi nuk varet nga rezultati akademik por nga mënyra si njerëzit do të jetojnë jetën e tyre.*³”

Pasqyrë më e detajuar e aktiviteteve të mësimin sipërmarrës në kontekstin ndërkombëtar është prezantuar në seksionin 1.2.

² Grupi Parlamentar Qeveritar i Westminster për Miro-ndërmarrje, nën-grupi për arrsim.

³ Thomas Cooney: The Need for Countries to Adopt an Entrepreneurship Education Strategy (http://sponsor.ja-ye.org/pls/apex31mb/f?p=17000:1003:477605035115808:::1003:P1003_HID_ID,P1016_HID_INSTITUTION_ID:12417,31743)

1.1 Konteksti vendor dhe qëllimi

Klima afariste në mënyrë të dukshme është përmirësuar gjatë viteve të fundit, veçanërisht në fushat si administrimi i tatimeve, regjistrimi i bizneseve dhe thjeshtësimi i rregullave dhe procedurave doganiere; sërish kishte marrë nota të larta nga anketa e Bankës Botërore për Zhvillimin e Biznesit për vitin 2014 (vendin e 25 nga 189 ekonomi). Mirëpo, akoma duhet të mendohet për përqindjen e lartë të papunësisë.

Republika e Maqedonisë është një vend me përqindje të papunësisë me rreth 30%. Kjo veçanërisht vlen për rininë, popullatën rurale, pakicat etnike dhe personat më pak të edukuar, dhe nga kjo del edhe një prej sfidave më kryesore të Republikës së Maqedonisë për të krijuar punë. Këto sfida mund vetëm të zgjidhen me krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e aktiviteteve sipërmarrës të gjithë personave që kanë ndikim të dukshëm.

Në lidhje me këtë përqindje të lartë të papunësisë në vend, duhet të marrim parasysh aktorët e ndryshëm që veprojnë në krijimin e politikave për sipërmarrje, inovacion, ngritje të konkurrencës dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor që ishte themeluar për të përgjigjur sfidave në të ardhmen (shikoni pikën 4: Aktorët dhe përgjegjësitë).

Nga Indeksi Politik për NMV 2012⁴ vërehet qartë që ka vend për përmirësime në dimensionin 1 "Mësimi Sipërmarrës dhe Sipërmarrëset Gra" dhe dimensionin 8a "Shkathtësitë Sipërmarrëse". Në veçanti, është identifikuar nevoja për përmirësime në procesin e mësimi sipërmarrës. Zbatimi i kësaj strategjie duhet të plotësojë këto vrima nga raporti i Indeksit Politik për NMV 2012, posaçërisht me krijimin e lidhjeve sistematike mes arsimit formal dhe biznesit dhe integrimi më i thellë i përvojës rajonale dhe praktikave më të mira (me anë të SEECCEL) në reformat e sistemit formal arsimor. Në anën tjetër, bashkëpunimi mes arsimit formal, joformal/informal dhe sektorit afarist do të mundësojë inkorporim të nevojave të vërteta të shkathtësive për sipërmarrje në sistemin arsimor.

Parimet kryesore të këtij dokumenti strategjik janë bazuar në kërkim të gjerë, të përforcuara me literaturë autoritative lidhur me fushën e MS. Këto janë:

- **Ngritja e vetëdijes së fuqishme mes gjithë qytetarëve në vend, pa dallim mosha e tyre, religjioni ose kombësia, që sipërmarrja mund të mësohet dhe sipërmarrësit mund të krijohen.** Me rëndësi është të rritet vetëdija në gjitha nivelet, që të gjithë do të mund të zbatojnë arsimin e përjetshëm lidhur me mësimin sipërmarrës - jo vetëm lidhur me arsimin formal, informal dhe joformal. Në anën tjetër, sipërmarrësit aktual dhe sipërmarrësit potencial pa dallim nga mosha e tyre mund të vetëdijësohen që mund të arrijnë suksesin e tyre sipërmarrës dhe do të kanë njohurinë e nevojshme për të arritur atë sukses. Krijuesit e politikave dhe kuadri arsimor gjithashtu duhet të vetëdijësohen për rëndësinë e mësimi sipërmarrës në krijimin e mirëqenies dhe përfitim të shoqërisë në përgjithësi.
- **Mbështetje e krijimit të shoqërisë inovative me njerëz mjaft inovativ dhe të ditur.** Inovacioni është një proces i lidhur ngushtë me sipërmarrjen, siç ka dhënë Peter Drucker⁵ "inovacioni është instrumenti specifik i sipërmarrjes....vepra që plotëson resurset me kapacitet të ri për të krijuar pasuri". Zhvillimi i shoqërisë inovative është një çështje tjetër që ky dokument strategjik ka ndërmend të trajtojë.

⁴ <http://www.oecd.org/globalrelations/psd/SMEWBalkansTurkey.pdf>

⁵ Peter Drucker: Innovation and Entrepreneurship, 1985

- **Programe të orientuar në praktikë për të lehtësuar mësimin sipërmarrës në arsimin formal - sepse mësimi mbi sipërmarrjen dhe inovacionin në arsimin formal është më i ndërlikuar se lëndët tjera.** Procesi i mësimin sipërmarrës kërkon zbatimin e ndryshimeve të mëdha të teknikave dhe metodave arsimore që vetëm më janë të vendosura/tradicionale. Programet lidhur me mësimin sipërmarrës duhet të jenë më praktik me orientim dhe të përdoren metoda më participative, duke u bazuar në jetën e vërtetë të punës dhe metodave dhe modelimin ose imitimin sa më afër që mundet e përvojave të vërteta sipërmarrëse.
- **Zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie do të sigurojë një mjedis për bashkëpunim mes aktorëve kryesor.**⁶ Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i përvojave të ndryshme ose praktikave më të mira është një prej mënyrave më të mundshme për zbatimin e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimin sipërmarrës. "Ajo që do të jetë e rëndësishme ose relevante për mësimin sipërmarrës sot do të jetë e vjetruar nesër".
- **Zbatimi i praktikave më të mira të mësimin sipërmarrës kërkon zhvillimin e duhur/përkatës të veglave të monitorimit, matjes dhe informacioneve kthyesë** për të siguruar që matja e rezultateve është mbuluar me anë të aktiviteteve përkatëse lidhur me mësimin sipërmarrës. Sistemet e monitorimit do të duhet të përgjigjen pyetjeve si sa biznese të vogla janë filluar; sa prej tyre mbijetojnë vitin e parë të operimit; sa mundësi të reja të punësimit janë krijuar, etj. Përveç matjeve të këtyre rezultateve të matura dhe "të forta", me rëndësi është që të regjistrohet edhe zhvillimi i shkathtësive të "buta". Sistemet përkatëse dhe me dizajn të duhur të vlerësimit janë të nevojshme sepse do të mundësojnë përputhje të caktua/zhvillimor të gjithë procesit mësimor, ashtu që rritja e mësimin mund të kapet dhe vlerësohet.
- **Mësimdhënësit për sipërmarrje janë thelbi i strategjisë efektive të mësimin sipërmarrës.** Përqendrimi kryesor do të duhet të jetë në përmirësimin e kompetencave, sigurimin e zhvillimit të rrjeteve të qëndrueshme të trajnerëve për mësimdhënësit të cilët do të jenë përgjegjës për teknika të reja mësimore lidhur me mësimin sipërmarrës, dhe të mundësojnë mësimin e vazhdueshëm sipërmarrës (*edukatorët kanë nevojë për trajnim dhe udhëzim përkatës - ata nuk janë më mbrojtësit e njohurisë - ata duhet të fuqizohen në "vjelësit e njohurisë"*)⁷.

Strategjia për mësimin sipërmarrës do të sigurojë mbështetje sistematike nga aktorët në një mjedis bashkëpunimi, që do të përfshijë nivele të larta nga gjithë aktorët (fëmijët, prindërit, mësimdhënësit, komuniteti lokal...). Nga ana tjetër, me anë të dokumentit strategjik dhe planit të veprimit do të jepet një pasqyrë më të qatë për financat e duhur dhe resurset financiare të cilat do të nevojiten gjatë periudhës vijuese për zbatimin e strategjisë. Arsimi më i mirë i mësimdhënëseve dhe trajnimit për mësimin e përjetshëm me kurrikulë më fleksibile do të përmirësojë më tepër ekosistemin e plotë të mësimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë.

Ky dokument strategjik është bazuar në kërkim të gjerë që është zhvilluar gjatë periudhës prej mars deri shtator 2013. Kërkimi ishte bërë në formë të kërkimit nga zyra (analiza e praktikave më të mira të strategjisë për MS dhe shumë artikuj tjerë lidhur me çështjen mësimin sipërmarrës),

⁶ Një prej sukseseve më të mëdha në arsim në Britani është ajo e prindërve dhe komunitetit lokal që secili vije në mjediset mësimore për të ndihmuar zhvillimet (shikoni: <http://www.readyunlimited.com>)

⁷ Michael Barber, Katelyn Donnelly, Saad Rizvi: An Avalanche is Coming – Higher Education and the Revolution Ahead, Instituti për Kërkim Publik Politik, mars 2013

intervista me gjithë aktorët relevant, pyetësorë, forum on-line dhe medie sociale. Këto detaje janë dhënë në raportin e inventarizimit.

1.2 Lidhjet me strategjitë dhe dokumentet tjera relevante

Lidhjet me strategjitë dhe dokumentet kryesore qeveritare

Në Republikën e Maqedonisë vetëm më ka shumë strategji dhe dokumente që lidhen me disa pjesë me mësimin sipërmarrës dhe me këtë dokument strategjik. Në interes të qartësisimit, do të theksohen vetëm ato më të rëndësishëm:

- **Programi Qeveritar i Punës për periudhën 2011-2015.** Dy prej pesë nga objektivat strategjike të këtij programi janë rritja ekonomike dhe punësimi, si dhe parakusht për rritjen e standardit të jetesës së qytetarëve dhe përmirësim të cilësisë së jetës si objektiv i parë strategjik dhe investim në arsim, shkencë dhe teknologji informatike si elemente të shoqërisë së bazuar në njohuri si objektiv i pestë strategjik. Strategjia e mësimin sipërmarrës gjithashtu do të mbështet zbatimin e ardhshëm të këtyre objektivave strategjike.
- **Programi Operativ Shumëvjeçar për Zhvillimin e Resurseve Njerëzore 2007 - 2013** (dokumentet e programimit dhe dy versionet e saja). Një prej prioriteteve strategjike të këtij dokumenti është arsimit dhe trajnimi - investimi në kapitalin njerëzor me anë të arsimit dhe shkathtësive më të mira. Strategjia e MS do të ketë kontribut të drejtpërdrejtë nëpërmjet modernizimit të sistemit të trajnimit dhe arsimit të Republikës së Maqedonisë dhe në promovimin e mësimin sipërmarrës gjatë gjithë jetës.
- **Strategjia Nationale për Zhvillim të Qëndrueshëm e Republikës së Maqedonisë.** Një prej prijësve strategjik të kësaj strategjie është inkorporimi i sektorit privat dhe ngritja e vetëdijes për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë. Strategjia për MS mund të përmirësojë më tej zbatimin e këtyre objektivave strategjike.
- **Plani i veprimit për punësimin e të rinjve 2015** gjithashtu përmban reforma në sistemin e arsimit dhe trajnimit që trajtojnë mësimin e përjetshëm dhe nevojat e përvetësimin të punësimin të rinisë të cilët janë jashtë sistemit formal arsimor. Në anën tjetër, ky plan gjithashtu ka një objektiv tjetër prioritar për të promovuar punësimin e të rinjve me anë të zhvillimit të sektorit privat. Strategjia e mësimin sipërmarrës do të bëhet forcë mbështetëse për zbatimin e këtij plani.
- **Strategjia nationale për zbutjen e varfërisë dhe inkluzion social 2010-2020.** Kjo strategji si qëllim kryesor e ka zvogëlimin e varësisë dhe marginalizimit social në Republikën e Maqedonisë me anë të përdorimit më të mirë të resurseve materiale dhe njerëzore në dispozicion, përmirësim kushteve për jetesë, kushteve të punës dhe sociale për gjithë qytetarët, aktivitetet sistimore dhe institucionale në funksion të zhvillimit të përshpejtuar, standard më i lartë dhe cilësi më e mirë e jetës. Strategjia përmban 14 fusha kryesore ku punësimi vije e para, ekonomia joformale dhe përforcimi i sipërmarrjes është e dyta dhe tregu i punës është fusha e tretë kryesore. Strategjia për mësim sipërmarrës do të ketë një rol aktiv në mbështetjen e gjitha këto tre fusha kryesore.
- **Strategjia nationale për zhvillimin e arsimit 2005-2015.** Strategjia për mësimin sipërmarrës mund të ndihmojë në promovimin e kulturës së jetesës si një prej fushave kryesore të intervenimit në strategjinë nationale për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në lidhjen e arsimit formal dhe informal, promovimin e mësimin të

përjetshëm dhe arsimit për të rritur. Fushat tjera kryesore ku strategjia e MS do të ndikojë dukshëm janë pjesëmarrja e rritur sociale, përmirësimi i konkurrencës së shoqërisë maqedonase dhe promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

- **Strategjia për inovacione e Republikës së Maqedonisë 2012 – 2020.** Kjo strategji merr parasysh gjendjen aktuale të zhvillimit në Republikën e Maqedonisë për të siguruar që politikat për promovimin e inovacioneve janë të përqendruar dhe relevant për vendin. Sipër strategjisë, deri në vitin 2020, Republika e Maqedonisë do të ketë sistem efektiv të inovacionit, të krijuar bashkë me gjithë aktorët dhe e hapur për botën. Për të plotësuar këtë vizion, janë përcaktuar katër objektiva strategjike në vetë strategjinë: 1. Përmirësimi i prirjes së sektorit afarist për të shpikur; 2. Përforsimi i resurseve njerëzore për inovacion; 3. Krijimi i një mjedisi të rregulluar për të mbështetur inovacionin; dhe 4. Zmadhimi i rrjedhjes së njohurisë dhe shkëmbimit mes aktorëve novatorë. Kjo strategji dhe strategjia për mësimin sipërmarrës kanë shumë gjëra të përbashkëta dhe plotësojnë njëra-tjetrën veçanërisht për objektin e dytë strategjik për resurse njerëzore në vend për inovacion. Meqë inovacioni në përgjithësi është pjesë e sipërmarrjes, reformat në arsimin formal lidhur me mësimin sipërmarrës, stimulimi i sipërmarrjes në gjitha nivelet të arsimit formal, joformal dhe informal dhe promovimi i mësimin të përjetshëm sipërmarrës si pjesë e strategjisë për mësim sipërmarrës do të ndihmojnë në krijimin e një sistemi efektiv kombëtar për inovacione.
- **Strategjia për arsim profesional dhe trajnim e Republikës së Maqedonisë dhe Plani i Veprimit 2013-2020.** Qëllimet kryesore të mbuluara nga strategjia për APT janë: 1. Përmirësimi i tërheqjes, relevancë dhe cilësisë së APT-së dhe mundësia për të luajtur një rol kryesor në përmirësimin e performancës profesionale, konkurrencës dhe inovacionit; 2. Të ofrojë mundësi të ndryshme dhe fleksibile për të rinjtë dhe të rriturit në përfitimin e shkathtësive që janë të nevojshme për zhvillimin e karrierës së tyre dhe që stimulojnë frymën sipërmarrëse, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në arsimin dhe trajnimin e mëtutjeshëm, dhe duke kontribuar për qytetari aktive dhe plotësim personal dhe 3. Të promovojë ekselencë dhe inkluzion social, të kontribuojë për punësim më të madh, mobilitet dhe siguri të punës, të përmirësojë parashikimin dhe menaxhimin e ndryshmeve të tregut të punës dhe të inkurajojë konkurrencën afariste. Strategjia për mësimin sipërmarrës si një dokument që do të ketë për objektin stimulimin e frymës sipërmarrëse mes njerëzve në gjitha nivele e vendit gjithashtu do të luajë rol të rëndësishëm në arritjen e këtyre qëllimeve.
- **Politikat industriale të Republikës së Maqedonisë 2009-2020.** Objektivi kryesor i Politikave Industriale 2009-2020 është të kontribuojë në rritjen e konkurrencës së industrisë vendore duke u bazuar në njohuri, inovacion dhe kërkim, krijimi klimës stimuluese afariste dhe investimi dhe mbështetja e kompanive në përpjekjet e tyre për të rritur avantazhet konkurruese duke përfutur më tepër njohuri, teknologji dhe tregje. Kjo strategji ka fokusuar masat në fushat vijuese: bashkëpunimi ndërkombëtar me aktorët kryesore ekonomik zhvillimor, kërkimi i aplikuar, zhvillimi dhe inovacioni, teknologji ekologjike, produkte dhe shërbime për zhvillim të qëndrueshëm, NMV dhe zhvillimi i sipërmarrjes dhe bashkëpunimi në grupe dhe rrjete. Strategjia për mësimin sipërmarrës me masat e saja do të ndihmojë në krijimin e një shoqërie me shkathtësi të larta për kërkime të aplikuara, zhvillim dhe inovacion dhe si plotësim për zhvillimin e sektorit të NMV dhe sipërmarrjes në vend.
- **Plani i veprimit për përmirësim të konkurrencës.** Ngritja e shkathtësive sipërmarrëse dhe biznese më sipërmarrëse në vend do të rrit konkurrencën dhe kompanive nga vendi.

- **Strategjia nacionale zhvillimore për NMV.** Ndonëse kjo strategji skadon në fund të vitit 2013, strategjia e re është në përgatitje dhe do të ketë ndikim mbi zbatimin e strategjisë së MS.

Lidhje me dokumentet e BE-së

Sipërmarrja në arsim ishte trajtuar me shumë iniciativa në nivelin e BE-së, mirëpo një prej më të rëndësishme përveç raporteve të ndryshme dhe kërkimeve është bërë **Agjenda e Oslos për Arsim Sipërmarrës në Evropë**⁸ e cila ka për qëllim të vazhdojë promovimin e çështjes së sipërmarrjes në shoqëri, në mënyrë sistematike dhe me veprime efektive. Një pjesë e rëndësishme e agjendës është ofrimi i propozimeve konkrete që mund të përshtaten nga aktorët sipas kontekstit lokal.

Në **Planin e Veprimit të BE-së për Sipërmarrje 2020**⁹ (Ndezja e frymës sipërmarrëse në Evropë) mësimi sipërmarrës është pjesë e shtyllës së parë të veprimit: Arsimi sipërmarrës dhe trajnimi për të mbështetur rritjen dhe krijimin e bizneseve ku fokusi kryesor është në rritjen e shtrirjes dhe cilësisë së mësimi sipërmarrës, njohja dhe vlerësimi i mësimi sipërmarrës në mjedis mësimor informal dhe joformal, mekanizma krijimin e bizneseve me mbështetjen e universiteteve dhe eko-sistemi universitar afarist rreth sfidave kryesore shoqërore.

Ri-mendimi i arsimit: Investimi në shkathtësi për rezultate më të mira socio-ekonomike¹⁰ është një dokument tjetër kryesor kur një prej sfidave të shteteve anëtare është trajnimi çështjes së krijimit të shkathtësive për shekullin 21 dhe sërish, kjo sfidë përfshin mësimin sipërmarrës:

Përpjekjet duhet veçanërisht të përqendrohen në zhvillimin e shkathtësive sipërmarrëse, sepse ata jo vetëm që kontribuojnë në krijimin e bizneseve të reja, por gjithashtu edhe mundësojnë punësimin e brezit të ri.

Përveç kësaj, **Akti i BE-së për Biznese të Vogla**¹¹ njihet si një prej shtytësve kryesor të politikave për këtë strategji për mësimin sipërmarrës- nga e cilat gjitha zhvillimet strategjike të mësimi sipërmarrës në rajonin e para-aderimit kanë rrjedhur. Përveç kësaj, ABV është një pjesë integrale e Europe 2020¹² strategjisë për rritje të mençur, qëndrueshme dhe inkluzive dhe SEE2020¹³ – një strategji me qëllime përkatëse për rajonin e para-aderimit që pasqyron rritjen dhe punësimin e BE 2020. ABV-ja paraqet një pikë kryesore e përpjekjeve të BE-së (dhe rajonit të para-aderimit) për të plotësuar objektivat e konkurrencës dhe punësimi të BE-së (ritje dhe vende pune).

Andaj, kjo strategji për mësimin sipërmarrës është pjesë e përpjekjeve të vendit për integrim në BE. Me mundësimin e bizneseve të vogla dhe të mesme të konkurrojnë në tregun e gjerë të BE-së do të mbështet vendin që të realizojë këto kritere të aderimit (Kriteret e Kopenhagës).

Republika e Maqedonisë si anëtare e aktive e **Qendrës së Evropës Juglindore për Mësim Sipërmarrës (SEECEL)** mbështet misionin e saj në pajtim me politikat dhe praktikatat në mësimin

⁸ http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/files/support_measures/training_education/doc/oslo_agenda_fin_en.pdf

⁹ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0795:FIN:EN:PDF>

¹⁰ http://ec.europa.eu/education/news/rethinking/com669_en.pdf

¹¹ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2008:0394:FIN:EN:PDF>

¹² <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>

¹³ <http://ow.ly/mRuod>

sipërmarrës gjatë gjithë jetës me ata të Bashkimit Evropian. Kjo strategji do të përdor rezultate e realizuar nga SEECEL në katër shtylla kryesore strategjike:

- Zhvillimi i kompetencës kryesore të sipërmarrjes (niveli 2 ISCED);
- Promovimi i sipërmarrjes në nivelin e tretë arsimor (niveli 5/6 ISCED) në kuadër të disiplinave jo-afariste;
- Analizimi i nevojave për trajnim të bazuar në ndërmarrje
- Diseminimi dhe promovimi i politikave të mira dhe praktikës së mirë.

Andaj, strategjia maqedonase për mësimin sipërmarrës është bazuar në rekomandime kryesore të BE-së për zhvillimin e frymës sipërmarrëse në gjithë popullatën.

Gjithashtu, Republika e Maqedonisë është prej vendeve që ka firmosur strategjinë SEE2020 ku mësimi sipërmarrës është theksuar si një prej kompetencave kryesore¹⁴. Ky dokument strategjik do të kontribuojë në zbatimin e strategjisë SEE2020 në Republikën e Maqedonisë.

¹⁴ <http://www.rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

2. VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET KRYESORE

2.1 Vizioni i mësimi sipërmarrës

Maqedonia – vendi me kulturë mjaft të zhvilluar sipërmarrëse dhe një frymë që inspiron secilin.

Republika e Maqedonisë synon të bëhet një vend me kulturë dhe frymë të zhvilluar sipërmarrëse, një që përcillet në moshë dhe inspiron secilin në shoqëri me anë të kreativitetit, inovacionit, marrjes së iniciativave dhe qëndrimit konkurrues ndaj mësimi për të pasur sukses.

Zbatimi i strategjisë për mësim sipërmarrës kërkon një përkushtim të fortë nga ana e vendimmarrësit dhe edukatorët – në mënyrë që ne mund të pajisim mirë të rinjtë. Megjithatë, duhet të përfshihet e gjithë shoqëria dhe secili me njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe eksperiencë për të dëshiruar të krijojë mundësi për veten duhet të inkurajohet që të merr këto hapa. Të qenit sipërmarrës gjithashtu nënkupton të jesh i përgatitur për vendet e punës për të ardhmen.

Një prej gjërave që synon të qartësojë kjo strategji është se sipërmarrja nuk është diçka që nuk mund të mësohet, ose të zbatohet për të zhvilluar frymën sipërmarrëse në pajtim me shoqërinë mbështetëse sipërmarrëse dhe me qytetarët që kanë njohuri në fushën e sipërmarrjes. Përkundrazi, ajo është diçka që mund të mësohet dhe zbatohet. Gjithashtu, ajo nuk vlen vetëm para që dëshirojnë të krijojnë biznese të reja, por gjithashtu krijon persona më të pajisur për t'i ndihmuar. Kompetenca më të mira për gjithë personat dhe kushte pune të ardhshme janë një mënyrë alternative e shqyrtimit të kësaj nevojë të domosdoshme shoqërore.

2.2 Misioni i mësimi sipërmarrës

Strategjia për mësimin sipërmarrës do të:

- Përmirësojë shkathtësitë për punësim të personave të rinj në vend që do të rezultojë me mundësi më të mëdha për punësim të rinisë. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në rritjen e produktivitetit dhe konkurrencë së ndërmarrjeve maqedonase.
- Krijojë mundësi për secilin në vend që të pajisjet me kompetencat e nevojshme sipërmarrëse. Kjo nuk do të jetë diçka që vlen vetëm për individët me “talent të lindur sipërmarrës”. Në fakt, strategjia do të ndihmojë që të zvogëlohet pabarazia në të ardhura dhe siguron më tepër mundësi për një spektër më të gjerë të shoqërisë.
- Krijojë një sistem të përjetshëm për mësimin sipërmarrës – me anë të shkollave të fuqishme sipërmarrëse, vetëdije të lartë mbi mësimin sipërmarrës me teknologji më bashkëkohore, inovacion institucional në shkolla, reforma në kurrikulin në gjitha nivelet dhe zhvillim të vazhdueshëm të mësimdhënësve dhe diseminim të praktikave më të mira mes gjithë palëve dhe aktorëve,
- Përforcojë frymën sipërmarrëse, mënyrën sipërmarrëse e të menduarit dhe vepruarit, të menduarit inovativ, kreativitet, qëndrime që ndërmarrin rreziqe dhe fleksibilitet ndaj ndryshimeve – me anë të parimeve të përjetshme që zbatohen në gjitha segmentet e sistemit arsimor (formal, joformal, informal, etj):

- Zhvillojë një shoqëri më të arsimuar në kuptimin e sipërmarrjes që do të udhëheq drejt rrugës për zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitetit Republikën e Maqedonisë.
- Zhvillojë mënyrën sipërmarrëse të të menduarit dhe vepruarit.
- Lehtësojë zhvillimin e gjeneratave të reja me mendje të lirë, të pavarur dhe proaktiv që mund të kërkojnë dhe shprehin potencialin e tyre sipërmarrës.
- Lehtësojë zhvillimin e gjeneratave të suksesshme të sipërmarrësve të cilët d të mund të mbështeten në kompetencat e tyre.
- Krijojë rrjete inovativ/kreative të sipërmarrësve që janë të mbështetur nga resurset lokale dhe institucionale për të promovuar produktet maqedonase dhe shërbimet në tregjet ndërkombëtare dhe të mbështesin në mënyrë aktive aktivitetet e mësimit sipërmarrës në arsim.

2.3 Qëllimet kryesore¹⁵

Qëllimet afatgjate (prej 4 deri 6 vite)

Kjo strategji për MS në kuptimin afatgjatë do të kontribuojë në rritjen e numrit të NVM-ve (përfshirë edhe sipërmarrësit e rinj dhe gra) me aftësi të fuqishme të konkurrojnë në tregun e gjerë të BE-së, të rrit numrin e bizneseve të reja, të rrit numrin e kompanive të reja inovative me patentë të regjistruar që kanë përqindje të madhe të komercializimit dhe të zvogëlojë gradualisht përqindjet e papunësisë deri në më pak se 25%. Për të plotësuar këtë qëllim, kjo strategji për sipërmarrje do të:

1. Rrit nivelin e vetëdijes mes gjithë qytetarëve për domethënien dhe rëndësinë e mësimit sipërmarrës në gjitha nivelet e vendit.
2. Rrit kompetencat e mësimeve për mësime sipërmarrës në gjitha nivelet e arsimit – do të mundësojë që secili mësime të jetë i aftë në kuptimin sipërmarrës me MS si një prej kompetencave kryesore.
3. Krijojë mjedis mbështetës dhe bashkëpunues mes gjitha institucioneve arsimore për sipërmarrje, bashkësisë lokale, bizneseve dhe familjeve për aktivitetet e mësimit sipërmarrës në gjitha nivelet e vendit.
4. Pajis gjitha institucionet arsimore me teknologjitë më bashkëkohore për aktivitetet e mësimit sipërmarrës në gjitha nivelet e arsimit nëpër gjithë vendin.

Qëllimet afatmesme (prej 2 deri 4 vite)

Për të mbështetur arritjen e qëllimeve afatgjate, Republika e Maqedonisë do të duhet që të:

1. Zhvillojë dhe zbatojë kurrikul arsimor që më mirë përgatit sipërmarrësit të krijojnë NVM që do të mund të konkurrojnë në tregun e gjerë të BE-së.

¹⁵ Sqarime të hollësishme të qëllimeve strategjike janë prezantuar në pjesën 7. Qëllimet dhe harta, në këtë dokument

2. Krijojë më tepër kompani të vërteta me anë të institucioneve arsimore nëpër gjithë vendin.
3. Sigurojë që rrjete të fuqishme janë zhvilluar për të mbështetur sipërmarrësit e rinj.

Qëllimet afatshkurtër (prej tani deri më 2 vite)

Aktivitetet fillestare që mund të sjellin rezultat menjëherë për Republikën e Maqedonisë janë:

1. Integrimi i rezultateve të mësimit sipërmarrës në kurrikulin kombëtar për gjitha nivelet e arsimit si kompetencë kryesore.
2. Zhvillimi i vetëdijes për rëndësinë e mësimit sipërmarrës nëpër gjithë popullatën.

3. MËSIMI SIPËRMARRËS SI KOMPETENCË KRYESORE

Teoria dhe praktika tregojnë që sipërmarrësit mund të krijohen. Mirëpo, pyetja mbetet si të krijohen ato në baza strategjike dhe si arsimit formal, informal dhe joformal mund të ndihmojë në krijimin e sipërmarrësve të mëdhenj në Republikën e Maqedonisë, për të siguruar zhvillimin afatgjatë të qëndrueshëm dhe prosperitetin e vendin.

Sipërmarrja nënkupton aftësia e një individ të kthejë idetë në veprim. Ajo përfshin kreativitet, inovacion dhe marrje e rrezikut, si dhe aftësia për të planifikuar dhe menaxhuar projekte për të arritur qëllimet¹⁶. Kjo mbështet të gjithë në jetën e përditshme në shtëpi dhe në shoqëri, i bën punonjësit më të vetëdijshëm për kontekstin e punës së tyre dhe më mirë të shfrytëzojnë mundësitë dhe siguron një bazë për sipërmarrësit të vendosin aktivitetet sociale ose komerciale.

Sipërmarrja është një proces më i ndërlikuar saqë mund të përshkruhet në kurrikule të ndryshme, sepse situatat e ndryshme në bazë të industrisë, tregut, kulturës së vendit dhe faktorë tjetër, do të kërkojnë qasje të ndryshme në zbatimin e sipërmarrjes. Për momentin, shumë prej lëndëve arsimore në gjitha nivelet përdorin një mjedis të thjeshtë në laboratorët e trajnimit ku gjithë studentët mund të testojnë problemet e njëjta përnjëherë. Mirëpo, situata tipike e zgjedhjes së problemit me të cilën hasen sipërmarrësit karakterizohet me nivel të lartë të pasigurisë, qëllime të dobëta, shumë të panjohura, shtypje më të madhe dhe mbingarkim i madh me informacione.

Ne nuk mund të garantojmë që procesi klasik arsimor që është paracaktuar më herët mund të sjell rezultatet e duhura për krijimin e një gjenerate të re të sipërmarrësve, në fakt, gjithçka sugjeron që nuk do të rezultojë. Andaj, kërkimi tradicional pedagogjik dhe psikologjik në lidhje me stilet e mëhershme të mësimdhënies dhe proceset mësimore nuk mund të zbatohen drejtpërdrejtë për mësimin sipërmarrës.

Për shkak të lidhjeve të fuqishme mes “shkencës” dhe “artit të sipërmarrjes: dhe për shkak të suksesit të çdo biznesi që është në pjesë të madhe e mbështetur në anën artistike ku idetë reja, unike dhe inovative në formë të produkteve dhe shërbimeve të reja në treg, shumë vende tentojnë të zbatojnë ndryshime të rëndësishme në sistemet e tyre arsimore. Mbështetja e studentëve të ndërtojnë shkathtësi të lidhura me anën “artistike” do të plotësojë anën e shkencës të njohjes si funksionon biznesi dhe të mbarë qëndrojnë veten.

Në lidhje me rekomandimin e Parlamentit Evropian dhe këshillit të 18 dhjetorit 2006¹⁷ në lidhje me **kompetencat kryesore**¹⁸ për mësimin e përgjithshëm, ndjenja e iniciativës dhe sipërmarrjes është një prej tetë kompetencat kryesore.

¹⁶ http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/promoting-entrepreneurship/education-training-entrepreneurship/index_en.htm

¹⁷ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006H0962:EN:NOT>

¹⁸ Kompetencat kryesore të mësimin të përgjithshëm janë kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve lidhur me kontekstin e dhënë. Ata në veçanti janë të nevojshme për plotësimin personal dhe zhvillimin, inkluzionin social, qytetari aktive dhe punësim. Kompetencat kryesore janë të nevojshme për një shoqëri me njohuri dhe garanton fleksibilitet më të madh në fuqinë punëtore, duke lejuar të adaptohet më shpejtë ndaj

Kjo ndjenjë e iniciativës dhe sipërmarrjes është definuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli si:

Aftësia e një individi të kthejë idetë në veprim. Ajo përfshin kreativitet, inovacion dhe marrje të rrezikut, si dhe aftësia për të planifikuar dhe menaxhuar projekte për të arritur qëllimet. Kjo mbështet individët, jo vetëm në jetën e tyre të përditshme në shtëpi dhe shoqëri, por gjithashtu edhe në vendin e punës të jenë të vetëdijshëm për kontekstin e punës së tyre dhe të mund të shfrytëzojnë mundësitë dhe është baza për shkathtësitë më specifike dhe njohurinë e nevojshme për themelimin ose kontributin në aktivitete sociale ose komerciale. Kjo duhet të përfshijë vetëdije të vlerave etike dhe të promovojë qeverisje të mirë.

Në dokumentin e njëjtë, ka definicione për njohuritë themelore, shkathtësitë dhe qëndrimet lidhur me këtë kompetencë¹⁹:

- **Njohuritë** e duhura përfshijnë aftësinë për të identifikuar mundësitë në dispozicion për aktivitete personale, profesionale dhe/ose biznes aktivitete, përfshirë çështjet "me pasqyrën më të gjerë" që sigurojnë kontekstin ku njerëzit jetojnë dhe punojnë, sikur kuptimi më i gjerë i funksionimit të ekonomisë, dhe mundësitë e sfidat e ballafaqimit me një punëdhënës ose organizatë. Këto individë duhet të jenë të vetëdijshëm për pozitën etike të ndërmarrjeve dhe si ata mund të veprojnë pozitivisht, për shembull nëpërmjet tregtisë së drejtë ose ndërmarrjeve sociale.
- **Shkathtësitë** kanë të bëjnë me menaxhim proaktiv të projekteve (që përfshinë, p.sh.: shkathtësinë e planifikimit, organizimit, menaxhimit, udhëheqjes dhe delegimit, analizës, komunikimit, përcjelljen e informatave, vlerësimin dhe regjistrimin), përfaqësimin efektiv dhe negociimin, aftësinë e të punuarit edhe si individ edhe si bashkëpunëtor në ekipe. Aftësinë për të gjykuar dhe identifikuar anët e dobëta dhe të forta të një personi, të vlerëson dhe të rrezikon ku dhe kur duhet, e gjithë kjo është thelbësore.
- **Qëndrimi** sipërmarrës karakterizohet me iniciativë, pro-aktivitet, pavarësi dhe inovacion në jetën personale dhe sociale, po aq sa edhe në punë. Gjithashtu përfshinë motivacion dhe përkushtim për të plotësuar synimet, pavarësisht se a janë qëllime personale, ose qëllime të përbashkëta me bashkëpunëtorët në vendin e punës.

Kultivimi i frymës sipërmarrëse dhe sigurimi i rrethanave pozitive që përkrahin sipërmarrjen, bëhet pjesë e përgjegjësiave kyçe të sistemit arsimor. Zbulimet e fundit të kërkimeve të zhvilluara nga Komisioni Evropian sugjerojnë se ato persona që kanë kaluar programe dhe aktivitete sipërmarrëse, shfaqin më shumë qëllime dhe qëndrime sipërmarrëse, më herët punësohen pas përfundimit të studimeve, janë më inovativ, madje edhe si të punësuar në firma dhe nisin më shumë kompani.²⁰ Për këtë shkak, republika e Maqedonisë duhet të përfshin kreativitetin, inovacionin dhe sipërmarrjen në arsim. Ka nevojë për stimulim të mënyrës së menduarit sipërmarrës të të rinjve dhe të krijohet një klimë shoqërore më e favorshme për sipërmarrje. Arsimi ka rol kyç në përmirësimin e kompetencave kyçe të sipërmarrjes²¹ së qytetarëve maqedonas.

ndryshimeve të vazhdueshme në një botë të lidhur. Ata janë faktori kryesor në inovacion, produktivitet dhe konkurrencë dhe kontribuojnë në motivimin dhe plotësimin e punonjësve dhe cilësinë e punës.

¹⁹ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006H0962:EN:NOT>

²⁰ "Efektet dhe ndikimi i programeve sipërmarrëse në arsimin e lartë", për KE – DG Ndërmarrje dhe Industri, raporti ishte përgatitur nga EIM Kërkim Politik dhe Afarist, Holandë, 2012

²¹ 'Sipërmarrja dhe ndjenja e iniciativës është një prej tetë kompetencave kryesore të mësimin të përjetshëm që qytetarët përfitojnë për plotësimin e tyre personal, inkluzionin social, qytetari aktive dhe punësim në një shoqëri të bazuar në njohuri.

Të mësuarit sipërmarrës mund të definohet si proces ku shoqëria krijon persona sipërmarrës, jo vetëm pronar të bizneseve por edhe persona me njohuri dhe zakone pune për ardhmërinë, persona që do të jenë të gatshëm të ndryshojnë botën për më mirë, persona që do të kontribuojnë në shoqëri dhe do ti kthejnë shoqërisë që ua ka mundësuar të bëhet ato që janë bërë.

Republika e Maqedonisë është anëtare e SEECEL dhe e pranon definicionin e të mësuarit sipërmarrës. Kjo formalisht u pranua nëpërmjet nënshkrimit të SEECEL Kartës Rajonale për Mësim Sipërmarrës: “Themelet për rritje dhe vende pune”. Sipas këtij dokumenti, shtetet anëtare të SEECEL definojnë mësimin sipërmarrës si ²²:

“Koncept i arsimit dhe trajnimit që përkrah mënyrën sipërmarrëse të të menduarit dhe bazohet në zhvillimin e individëve, përfshirë parimet bazë të efikasitetit në jetën e përditshme pa ndonjë theks të posaçëm mbi nismën e bizneseve – ku e gjithë kjo shpie kah rritja e njohurive për sipërmarrjen për shoqërinë si tërësi”.

Veç kësaj, ekspertët nga shtetet anëtare të SEECEL kanë marr edhe një hap dhe kanë paraqitur termin shkrim/leximi sipërmarrës që shpie kah një shoqëri me njohuri elementare të sipërmarrjes si tërësi, ku secili qytetar duhet të jetë i aftë për sipërmarrje. SEECEL definon shkrim/leximin sipërmarrës si:

“Koncept i arsimit dhe trajnimit që përkrah mënyrën sipërmarrëse të të menduarit (dhe vepruarit) dhe bazohet në zhvillimin e individëve, përfshirë parimet bazë të efikasitetit në jetën e përditshme pa ndonjë theks të posaçëm mbi nismën e bizneseve”.

Sidoqoftë, për qëllimin e këtij dokumenti strategjik do të përdorim definicionin e ETF për të mësuarit sipërmarrës: **‘Të gjithë format e arsimit dhe trajnimit (formal, informal dhe joformal) që kontribuojnë frymën dhe sjelljen sipërmarrëse, me ose pa qëllime komerciale.’**

Kërkesa për të mësuarit sipërmarrës ka qenë dhe akoma është në rritje të vazhdueshme. Sidoqoftë, ka disa pengesa që pengojnë mësimin e sipërmarrjes. Për shembull, dihet se ka një mungesë në burimet njerëzore dhe financim të këtij lloji të arsimit, ka nivel të ulët të vetëdijes për rëndësinë e sipërmarrjes për zhvillimin ekonomik, etj. Veç kësaj, ekziston edhe tendenca tek bashkësia akademike/mësimdhënëse të vëzhgojnë sipërmarrjen vetëm si mënyrë për të nisur dhe drejtuar një biznes, kurse gjetja e mënyrave të ndryshme për sigurim të qëndrueshmërisë së bizneseve sigurisht që është sfidë më e madhe, siç është edhe zhvillimi i mësimave për persona që munden në mënyrë pro-aktive të përkrahin dhe të risin këto lloje të reja të bizneseve.

Roli kyç i mësimin të sipërmarrjes është të pajis të rinjtë (por jo vetëm të rinjtë) me kompetencat e nevojshme për shekullin 21. Gjithashtu, arsimit sipërmarrës është një vegël për rritje të inkluzionit social; mund të rrit numrin e sipërmarrëse – ato social dhe komercial, dhe mund të jetë zgjedhje për një integrim më të madh të kornizës për kompetencat kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës.

Në përgjithësi, ka dy lloje të terminologjisë të përdorura në këtë temë: arsimit sipërmarrës dhe mësimi sipërmarrës. Shumë ekspert nuk bëjnë dallim mes këtyre dy termeve. Duket se e përdorin termin edukimi sipërmarrës, që mbulon edhe fushën e mësimin sipërmarrës. Dallimi më i madh

²² <http://www.seecel.hr/UserDocsImages/Documents/Documents%20Section/SEECEL%20-%20Entrepreneurial%20Learning%20ISCED%20Level%202.pdf>

mes këtyre dy termeve është pjesa e dytë: **arsimi vs. mësimi**. Arsimi është proces i fitimit të kompetencave nëpërmjet mësimdhënie, që thjeshtë nënkupton transferimin e njohurive prej shoqërisë tek individët. Nga ana tjetër, mësimi është procesi i fitimit të kompetencave gjithashtu nëpërmjet mësimdhënies, por me elementin e përvojës dhe më shumë vet-iniciativa nga personi që dëshiron të mëson diçka të re.

Për këtë shkak, mësimi sipërmarrës është term shumë më i thellë; përfshinë aktivitete me shtrirje të gjerë që do të nxisin të menduarit sipërmarrës në shoqëri.

Veç kësaj, në vitet e fundit është rritur fokusi në “përvetësimin e punësimit” e studentëve dhe shkathtësitë për “punësim” si rezultat i sistemit të përgjithshëm arsimor. Në këtë drejtim, Sipërmarrja, Sipërmarrësia dhe përvetësimi i punësimit afrohen njëra tjetrës, por personat sipërmarrës duhet të jenë të aftë të gjejnë mundësi – ky është një parakusht i rëndësishëm. “Pa dyshim që mbulojnë pjesë të fushës së tjetrës... Arsimi Sipërmarrës mund të rrit arsimin e karrierave dhe përvetësimin e punësimit të studentëve duke ju mundësuar më shumë të ju përqendrohen mundësive, të jenë të vetëdijshëm dhe më të afërt me biznes mjedisin”²³

Sipas kësaj - “Tani, më shumë se kurrë, kemi nevojë për inovacion, zgjedhje të reja, qasje kreative dhe mënyra të reja të veprimit. Gjendemi në territor të panjohur dhe na duhen njerëz në të gjithë sektorët dhe nga të gjitha moshat që dinë “të mendojnë jashtë kornizave” të identifikojnë dhe ndjekin mundësi, në mënyra të reja dhe të ndryshme.”²⁴

²³ <http://www.gaa.ac.uk/Publications/InformationAndGuidance/Documents/enterprise-guidance.pdf>

²⁴ <http://www.weforum.org/reports/educating-next-wave-entrepreneurs>

4. AKTORËT DHE PËRGJEGJËSITË

Përgjegjësia kyçe për miratim dhe zbatim të Strategjisë dhe planit të veprimit të Mësimit Sipërmarrës do të jetë tek Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë. Nga pikëpamja organizative (vepruese) Strategjia MS do të drejtohet nga Komiteti drejtues MS, i përbërë nga pjesëmarrës të aktorëve relevant. Ata gjithashtu duhet të vëzhgojnë dhe vlerësojnë zbatimin strategjisë.

Përgjegjësitë për nismën dhe zbatimin e hapave specifik të veprimit janë përshkruar në plane veprimi përkatëse në aneksin e kësaj strategjie.

Lista indikative e aktorëve është paraqitur në vijim, sidoqoftë, kjo listë nuk është përfundimtare dhe do të rifreskohet vazhdimisht.

4.1. Komiteti Drejtues i MS

- **Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)** është përgjegjëse për çështje si arsimi, shkenca, teknologjia, dhe kërkim dhe zhvillim. Gjithashtu, MASH nëpërmjet Departamentit për Shkencë, Zhvillim Teknik dhe Teknologjik është ministria kryesore e përfshirë në shkencë dhe K&ZH në nivel operacional. Kjo ministri siguron fondet e nevojshme për zhvillimin e shkencës dhe arsimit shkencor, projektet kombëtare për zhvillim të kërkimit dhe teknologjisë, dhe zhvillimin e kërkimit dhe teknologjisë së infrastrukturës. Gjithashtu, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Inovacion, të miratuar kohët e fundit, MASH planifikon zhvillimin e Departamentit për Inovacion, Konkurrencë dhe Sipërmarrësi në kuadër të Ministrisë. Ky Departament do të ja dorëzon qeverisë propozimet mbi politikën në fushën e inovacionit, do të monitoron dhe analizon trendet dhe standardet evropiane dhe globale në inovacion, dhe propozimin e masave për zbatim në Republikën e Maqedonisë. Departamenti gjithashtu do të monitorojë zbatimin e operacioneve ekzistuese në drejtim të aktiviteteve të inovacionit dhe do të propozojë masa në përputhje me potencialin e zhvillimit të Republikës së Maqedonisë, do të ofrojë mendime, sugjerime dhe udhëzime për bashkëpunim ndërkombëtar, do të realizon bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe do të siguron përfaqësimin e personave të përfshirë në aktivitet inovativ në inovacionin evropian dhe ndërkombëtar. Sektorët kryesor që do të përfshihen në strategjinë MS janë sektorët për arsimin fillor dhe të mesëm dhe sektori për arsim të lartë.

Ministria e ekonomisë (ME) ka përgjegjësi të përgjithshme për strategjitë kombëtare për zhvillim të NVM-ve, investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD), dhe politikave industriale, veçanërisht nëpërmjet Departamentit për Sipërmarrëse dhe Konkurrencë të NVM-ve, që zhvillon akte legislative për NVM-të, siguron fonde qendra fillestare të dhe inkubatorë të biznesit, mbështet sipërmarrjen tek gratë, mbështet rritjen e biznesit, inkubatorët e biznesit dhe organizatat rajonale për mbështetje të biznesit, mbështet NVM-të në zbatimin e ISO dhe HASSP standardet, etj. Departamenti për Politika Industriale është përgjegjës për zhvillimin e politikave industriale, zgjedhjen e fushave kyçe për zhvillim, duke siguruar masa për rritjen e aftësisë konkurruese të industrisë, grupimin, etj. ME ka qenë edhe gjeneratori kryesor për zhvillimin e strategjisë së Inovacionit Kombëtar 2012-2020, dhe ME do të ketë përgjegjësi në mundësimin e mjedisit mbështetës për strategjinë MS, sidomos duke ndihmuar në sigurimin e mbështetjes nga biznesi sektori.

- **Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPÇS)** përveç aktiviteteve tjera standarde, mban përgjegjësinë për zbatimin e të gjitha programeve për uljen e shkallës të papunësisë në nivel

kombëtar. Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Agjencinë për Promocion të Sipërmarrjes në Republikën e Maqedonisë, MPÇS zbaton disa masa aktive për punësim (përkrahje për punësim të të rinjve, të papunësuarve afatgjatë, grupeve të ndjeshme, grave, etj.)

- **Kabineti i Zëvendës Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Ekonomike** udhëheq me agjendën e politikave për inovacion dhe koordinim të Strategjisë Kombëtare për Inovacion. Zëvendës Kryetari për Çështje Ekonomike ka përgjegjësi të përgjithshme për reforma të politikave ekonomike, përfshirë biznes mjedisin, NVM, IJD dhe reformat rregullatore, si dhe koordinimin dhe zbatimin..
- **Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZHA)** është agjenci, entitet i posaçëm ligjor, në suaza të MASH, përgjegjëse për zhvillimin e programeve mësimore (qëllimet, përmbajtja, metodologjia, etj.) për arsimin parashkollor, arsimin fillestar dhe arsimin e mesëm (gjimnazet). BZHA ka zhvilluar programe për Inovacion dhe Sipërmarrje për shkolla të mesme (për vitet e 1,2,3 mësimore) dhe Biznes dhe Sipërmarrje për vitet e 4 (in 2012); për lëndën “inovacione” në klasën e IX-të të arsimit fillor (2014); gjithashtu edhe për zbatimin e përmbajtjeve të Inovacionit dhe Sipërmarrjes në lëndët e matematikës, kimisë, biologjisë, fizikës, informatikës dhe artit në klasën e 8 të arsimit fillestar. Gjithashtu janë paraparë plane të mëtutjeshme për nismën e lëndës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes për klasat e ulëta të shkollave fillore.
- **Qendra për Arsimin e të Rriturve (QAR)** është institucion publik për arsim të të rriturve në Republikën e Maqedonisë, si entitet i posaçëm ligjor, i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në nëntor të vitit 2008. Misioni i Qendrës është të promovon sistem për arsimin e të rriturve që do të jetë funksional, modern dhe në pajtim me standardet e BE-së, sistem që do të ofron mundësi për mësim me cilësi të larta për të fituar kualifikime që do t’ju përgjigjen nevojave të popullatës, do të përmirëson shkallën e punësimit dhe do të zhvillon sipërmarrjen, do të plotëson nevojat e tregut të punës dhe do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe personal.
- **Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (APT)** është themeluar me pajtimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si institucion publik për përputhje dhe integrim të interesave publike dhe interesave të partnerëve social në arsim profesional dhe trajnim. Qendra kryen mbikëqyrje të specializuara, vlerësim, studime, promovim, dhe kërkim dhe zhvillim për arsim profesional dhe trajnim, dhe detyra tjera në pajtim me Ligjin dhe Statutin. Mes aktiviteteve tjera, APT qendra është përgjegjëse për zhvillimin e kornizës kombëtare për kualifikime profesionale; zhvillimin e standardeve arsimore (profileve arsimore, planeve dhe programeve), përkrah partneritetin social në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe realizimit të arsimit profesional, etj.
- **Agjencia për Promovimin e Sipërmarrjes në Republikën e Maqedonisë - APSRM** si institucion në pronësi të shtetit, që është themeluar për të zhvilluar programe mbi masat, aktivitetet për promovim të sipërmarrjes dhe krijimin e bizneseve të vogla, dhe programe tjera të miratuara nga qeveria që kanë të bëjnë me sipërmarrje dhe biznese të vogla, kjo agjenci është një prej aktorëve më të mëdhenj në zbatimin dhe koordinimin e përkrahjes kombëtare dhe ndërkombëtare për sektorin e NVM.
- **Agjencia për Punësim (AP)** e Republikës së Maqedonisë është edhe një organizatë relevante publike, e cila nëpërmjet masave të shumta aktive për punësim përkrah krijimin e një numri të kompanive fillestare. Në suaza të programit për vet-punësim që zbatohet bashkërisht me MPÇS, UNDP dhe APSRM, më shumë se 4900 biznese fillestare janë krijuar në 5 vitet e fundit.

- **Biznes sektori**, me një përfaqësues prej:
 - Odave Ekonomike të Maqedonisë
 - Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore
 - Odës Ekonomike të Maqedonisë
 - Shoqatës së Punëdhënësve
 - Biznes Konfederata e Maqedonisë
 - Sipërmarrës
- Përfaqësues të universiteteve

4.2. Aktor tjerë kombëtar

- **Ministria e Financës (MF)** është institucioni kryesor përgjegjës për sigurimin e buxhetit kombëtar dhe financave të duhura. Përfaqësuesit prej MF sigurojnë koordinimin e buxhetit shtetëror brenda institucioneve të ndryshme të përfshira në zbatimin e strategjisë MS.
- **Komisioni Kombëtar për Inovacion dhe Sipërmarrësi** – KKIS është krijuar në vitin 2011 nga kryeministri. Qeveria ka emëruar anëtarët nga ministrinë kyçe, akademina, dhe biznes sektori. Qëllimi kryesor i këtij organi është komercializimit i inovacionit dhe rritja e nivelit të aktiviteteve të inovacionit në biznes shoqërinë dhe shoqërinë në tërësi. KKIS është përgjegjës për koordinimin e politikave qeveritare dhe masat për rritjen e inovacionit dhe konkurrencës; koordinimin e shpërndarjes së buxhetit sipas prioriteteve qeveritare, vëzhgimi i punës së Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, rishikimi dhe miratimi i programeve për përkrahje të projekteve dhe programeve të Fondit, para se të përfundojnë në procedurë qeveritare, sigurimi i rekomandimeve për qeverinë sa i përket programeve dhe projekteve të organizatave ndërkombëtare për përkrahje dhe zhvillim të aktiviteteve inovative, monitorim i politikave dhe masave të Bashkimit Evropian dhe të shteteve me praktika më të mira në fushën e inovacionit, dhe vlerësimi i ndikimit të tyre, dhënia e rekomandimeve dhe propozimeve për ministrinë në lidhje me aktivitetet e tyre të ndërlidhura me inovacion, dhënia e rekomandimeve dhe propozimeve për ministrinë në lidhje me aktivitetet e tyre të ndërlidhura me biznes mjedisin, të drejtat e pronës intelektuale dhe përkrahje për aktivitetet inovative.
- **Agjencia Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet.** Me zbatimin programeve, Agjencia Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet ndihmon zhvillimin e një shoqërie të bazuar në njohuri, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, më shumë vende pune, dhe më të mira, dhe kohezion më të mirë social, duke siguruar njëkohësisht mbrojtje të mjedisit dhe veçanërisht shkëmbim, bashkëpunim dhe mobilitet në fushat e arsimit dhe trajnimit. Theks të posaçëm do të ketë rritja e shkathësive sipërmarrëse (edhe në vend, edhe jashtë vendit).
- **Rrjeti Kombëtar i Edukatorëve për Sipërmarrje.** Rrjeti Ndërkombëtar i Edukatorëve për Sipërmarrje (RNES) u themelua në nëntor të vitit 2011, nga Qendra Kombëtare për Zhvillim të Inovacionit dhe Mësimit Sipërmarrës, dhe nën përkrahje të Presidentit të Republikës së Maqedonisë, në praninë e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, dhe Ministrit të ekonomisë. Në RNES gjenden profesor dhe asistent nga universitetet dhe mësimdhënës që japin lëndën “Biznes dhe Sipërmarrje” dhe subjekte tjera të lidhur me ekonominë në shkollat e mesme në vend. Qëllimi

kryesor i rrjetit është të mundëson veglat e rrjetëzimit mes edukatorëve, që ata të shpërndajnë praktikat më të mira për të mësuarit sipërmarrës, mundëson zhvillimin e mësimdhënësve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të planeve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit.

- **Organizatat e studentëve.** Gati se gjitha fakultetet/universitetet kanë organizata të studentëve që janë lëvizësit kryesor të aktiviteteve të ndryshme jo-formale (politike, arsimore, ekonomike ose sociale) në komplekset universitare. Përveç aktiviteteve tjera, organizata e studentëve zakonisht organizojnë panairë të vendeve të punës, trajnime për sipërmarrje, punëtori mbi vet-punësim, etj. Në këtë pikëpamje, organizata e studentëve gjenden mes lëvizëse kryesor të zbatimit të strategjisë MS dhe planit të veprimit.

4.3. Partnerët ndërkombëtar dhe ekspertët:

- ETF, Delegacioni i BE në Republikën e Maqedonisë, organet kryesore të BE në Bruksel, SEECCEL, USAID, GIZ, ADA, SDC, SIDA, Ambasada e Britanisë, Ambasada e Norvegjisë, Ambasada e Turqisë, dhe shtete tjera që kanë marrëveshje bilaterale me Republikën e Maqedonisë, etj., do të kontribuojnë me përkrahje të aktiviteteve të posaçme në Strategjinë e MS, që janë në pajtim me prioritetet ndërkombëtare institucionale për përkrahje të Maqedonisë.

Zbatimi i strategjisë do të kërkon **udhëheqje dhe koordinim nga MASH**, dhe është e rëndësishme të përfshihen edhe aktorët tjerë që të sigurohet një proces efektiv i zbatimit. Një prej roleve kryesore të Komitetit Drejtues të Mësimit Sipërmarrës do të jetë të siguron se ekziston mjedis efektiv dhe mirë i menaxhuar që i plotëson zbrazëtitrat mes aktorëve të ndryshëm, duke krijuar bashkëveprime të fuqishme dhe kushte të bashkëpunimit mes tyre.

Komiteti Drejtues do të themelon nën-grupe pune në tema të ndryshme, për të siguruar zbatim më efektiv të strategjisë dhe proces të vazhdueshëm të komunikacionit (*Figura 1*). Në nën-grupet e punës (sipas temës dhe qëllimeve) gjithashtu do të ketë edhe përfaqësues dhe ekspertë nga institucione të ndryshme, sikur: Enti Shtetëror për Statistikë, Konferenca ndër-universitare (së paku 2-3 përfaqësues prej universiteteve të ndryshme), Qendra për Nisje të Bizneseve-Manastir, YES inkubatori Shkup, Qendra për Nisje të Bizneseve Shkup, Ekspert ndërkombëtar, etj.

Komiteti Drejtues i Mësimit Sipërmarrës do të zhvillon një statut të detajuar dhe procedura të Komitetit, përfshirë përgjegjësitë dhe planet e veprimit.




Figura 1: Tre nën-grupet e propozuara të Komitetit Drejtues të Mësimit Sipërmarrës dhe përbërja e tyre

5. SFIDAT

Të gjitha llojet e transformimeve janë të mbuluara me lloje të ndryshme të sfidave që zakonisht mund të jenë faktorë mjaft kufizues në sigurimin e zbatimit të suksesshëm të dokumenteve strategjike. andaj, e njëjta vlen edhe për këtë dokument strategjik. Meqë është me rëndësi të krijohet një aftësi e fuqishme për të përballuar sfidat me qasje konstruktive që nga fillimi të sigurohet zbatimi i suksesshëm i strategjisë për mësim sipërmarrës.

Sfidat më të mëdha për suksesin e këtij dokumenti strategjik të mësimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë do të jenë këto më poshtë, të dhënë në renditje prej më pak prioritar deri më ato më prioritet:

- **Sigurimi i mbështetjes nga gjithë aktorët përgjegjës në zbatimin e strategjisë për mësim sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë.** Sfida kryesore është që kjo strategji gjithashtu do të duhet të sigurojë është gjetja e mbështetjes së mjaftueshme për të gjithë në procesin e zbatimit. Nuk bëhet fjalë vetëm për institucionet arsimore formale dhe joformale dhe krijuesit e politikave, por gjithashtu do të ketë nevojë për krijimin e një mjedisi bashkëpunues në të cilën të gjitha pjesët nga arsimi formal, joformal dhe informal do të bashkëpunojnë në krijimin e një ardhmërie më të mirë. gjithashtu, përfshirja dhe përkushtimi i ndërmarrjeve për të marrë pjesë në aktivitetet relevante të strategjitë për MS do të jetë një prej faktorëve më të rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm.
- **Resurse të kufizuara financiare, resurse njerëzore dhe kohë.** Si çdo herë, resurset e kufizuara financiare, por gjithashtu edhe ato njerëzore mund të bëhen një prej pengesave më të mëdha për zbatimin e suksesshëm të kësaj strategjie. Sfida e tjetër janë personat që do të jenë një linjë e parë të zbatimit të kësaj strategjie (mësimdhënësit dhe menaxherët e shkollave) që gjithashtu duhet të bëjnë më tepër përpjekje për të cilën do të duhet më tepër kohë të përkushtuar nga ana e tyre.
- **Krijimi i kurrikulit fleksibil veçanërisht në fushat e lidhur me mësimin sipërmarrës dhe e pike prekëse me lëndët tjera mësimore në arsimin formal, informal dhe joformal.** Kjo është një sfidë e rëndësishme sepse qëllimi kryesor i kurrikulit është që të arrijë të përgatit studentët për punët që akoma nuk ekzistojnë në treg. Kurrikuli fleksibil do të shmang nivelin e lartë të gjeneralisimit aktual të sistemit arsimor në krijimin e njohurisë për gjithçka për secilin, andaj do të kontribuojë në krijimin e personave më shkathtësi të përgatitur për vendet e ardhshme të punës që madje nuk ekzistojnë aktualisht.
- **Ngritja e nivelit më të lartë për studentë, prindër dhe mësimdhënës dhe gjithë palët në procesin e mësimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë.** Studentët dhe mësimdhënësit janë një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimin sipërmarrës, por gjithashtu ka edhe shumë ndikime tjera që vërtetë mund të ndikojnë mbi zbatimin e strategjisë. Meqë një prej sfidave të strategjisë është të krijojë një nivel mjaft të lartë të vetëdijes në mesin e studentëve, prindërve, mësimdhënësve dhe komunitetit lokal dhe kombëtar që do të ketë në rol mbështetës në procesin e mësimin sipërmarrës.
- **Përpilimi i programeve për trajnimin e mësimdhënësve që do të pasqyrojnë nevojat e vërteta të tregjeve aktuale dhe të ardhshme.** Zhvillimi i mësimdhënësve është një prej shtyllave kryesore të kësaj strategjie dhe nga kjo me përpilimin e programeve për trajnim të mësimdhënësve që do të sigurohet zbatimi i suksesshëm i strategjisë do të jetë një sfidë plotësuese.

- **Përfshirja dhe përkushtimi i ndërmarrjeve për të marrë pjesë në aktivitete relevante të strategjisë për MS.** Përfshirja e drejtpërdrejtë e kompanive në procesin arsimor është vendimtare për zbatimin e suksesshëm të strategjisë.

6. FUSHAT PRIORITARE

Fushat me prioritet të lartë për strategjinë e mësimit sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë gjenden në pesë shtyllat kryesore të dhëna më poshtë, ndërsa teknologjia dhe praktikat e mira janë shtytësi i kësaj strategjie që do të zmadhojnë vetëdijen e përgjithshme për MS dhe do të rezultojë me reformave dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve (dhe provajderëve). Të gjitha këto janë parakusht për plotësimin e vizionit të strategjisë për MS - për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe prosperitet për Republikën e Maqedonisë dhe shteti të bëhet një vend me kulturë sipërmarrëse mjaft të zhvilluar dhe frymë që inspiron secilin.




Figura 2: Eko-sistemi i mësimit sipërmarrës

Siç mund të vërehet nga figura më lartë, ka pesë shtylla si pjesa qendrore e eko-sistemit për mësim sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë dhe këto shtylla janë sqaruar më tepër më poshtë. Ekziston një themel kryesor që drejtpërdrejtë do të formojë zbatimin e aktiviteteve për Mësim Sipërmarrës - për të mbështetur rritjen ekonomike dhe zhvillimin e Republikës së Maqedonisë. Por, me rëndësi, ka edhe pesë mbështetës energjetik që do të përkrahin zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimit sipërmarrës në vend.

Mbështetësi i parë energjetik është **krijimi i nivelit të lartë të vetëdijes** në gjithë rrethinën mbi domethënien e vërtetë dhe rëndësinë e mësimit sipërmarrës. Vetëm me vetëdijes të fuqishme do të sigurohet mbështetje adekuatë për gjitha aktivitetet lidhur me këtë strategji. Gjatë krijimit të eko-sistemit të suksesshëm për mësim sipërmarrës duhet të bëhen **reforma** thelbësore, përfshirë edhe

rregulloret që kanë lidhje me mësimin sipërmarrës dhe arsimin në përgjithësi dhe **zhvillim të vazhdueshëm të mësimdhënësve** në këtë fushë. Ky është mbështetësi i dytë energjetik në ekosistemin e mësimit sipërmarrës që do të zhvillohet me këtë strategji. Mbështetësi i tretë energjetik është **teknologjia** që nënkupton përdorimi i teknologjisë më bashkëkohore për zbatimin e aktiviteteve të mësimit sipërmarrës do të sjell kompetenca më të mira për të gjithë në procesin. Si mbështetës i katërt energjetik janë **praktikat e mira** që nënkupton zbatimin e qasjes sistematike në zhvillimin, zbatimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira lidhur me zbatimin e aktiviteteve për mësimin sipërmarrës brenda dhe jashtë vendit. Në fund, ky eko-sistem është bazuar në krijimin e **bashkëpunimit ndërkombëtar** mes institucioneve arsimore në vend për të shkëmbyer dhe freskuar mësimin sipërmarrës me informacione të reja.

Në përgjithësi, në gjitha nivelet formale arsimore, strategjia e MS do të kërkojë përfundimin e qasjes sistematike në ndërtimin e institucioneve për arsimin sipërmarrës me anë të përfundimit të sistemeve menaxheriale dhe aleancave strategjike në mënyra formale dhe informale me bizneset dhe komunitetin lokal. Nuk bën dallim vendndodhja e institucioneve arsimore formale, as madhësia dhe historia paraprake, të gjithë ata do të kanë qëllim e njëjta dhe do të përdorin procese të unifikuara të punës.

Strategjia për MS nuk do të kërkojë ndryshime të mëdha të ligjeve, por për të siguruar që strategjia të zbatohet tërësisht pa ndonjë improvizim, do të ketë nevojë për një analizë më të thellë të ligjeve aktuale, posaçërisht në fushat e sigurimit të kushteve solide për aleanca strategjike dhe bashkëpunim mes institucioneve për arsim sipërmarrës dhe komunitetin lokal dhe afarist dhe punë praktike për studentët dhe zbatimin e projekteve sipërmarrëse drejtpërdrejtë në tre pa dallim nga niveli i arimit.

Strategjia për MS do të kërkojë krijimin dhe zbatimin e rezultateve specifike sipërmarrëse për gjitha nivelet formale arsimore që do të mbështesin më mirë integrimin e mësimit sipërmarrës në kurrikulin dhe zhvillim më të përqendruar të mësimdhënësve dhe pajisje me vegla dhe materiale që do të mundësojnë shkëmbimin e praktikave më të mira. Bashkëpunimi në nivelin institucional dhe ashtë kufijve të institucioneve nëpërmjet përfundimit të rritjes të edukatorëve për sipërmarrje do të jetë një mbështetje plotësuese të qëllimeve të strategjisë për MS dhe do të sjell përmirësim të vazhdueshëm të kurrikulit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në shkollat sipërmarrëse.

Disa prej shkathtësive që duhet të zhvillohen me anë të arsimit formal vetëm më janë pjesë e kurrikulit, por mungon një qasje më sistematike për zhvillimin e mësimdhënësve, zbatimin e praktikave më të mira dhe nivel të lartë të vetëdijes që do të mundësojë përmirësimin afatgjatë të praktikave sipërmarrëse në institucionet arsimore.

Në paragrafin më poshtë janë përfshirë gjitha shtyllat kryesore të eko-sistemit për mësimin sipërmarrës. Në bazë të kërkimit teorik, kërkimit praktik dhe praktikave më të mira nga vendet tjera²⁵, këtu kemi prezantuar parimet kryesore të kushteve që do të duhet të zhvillohen ose krijohen me zbatimin e strategjisë për MS.

²⁵ Analiza dhe kërkimi i përmendur është zhvilluar si pjesë e raportit "Grumbullimi i praktikave të mira" për strategjinë për MS

6.1 Arsimi fillor dhe parashkollor

Arsimi fillor si faza e parë e arsimit formal me një listë të lëndëve elementare është një prej fushave prioritare të kësaj strategjike sepse do të krijojë një vetëdije më të lartë mes nxënësve që prej moshës së tyre më të hershme. Të mësuarit për të qenë kreativ, për të punuar në ekipe, zgjedhja e problemeve praktike dhe prezantimi i zgjidhjeve të ndryshme, kërkimi dhe eksperimentimi me qasje të reja është diçka që mund të mësohet që prej moshës së hershme dhe si pjesë e arsimit fillor do të kontribuojë shumë në krijimin e frymës sipërmarrës në brezin më të ri të vendit. Ekzistojnë disa njerëz që pohojnë që në këtë moshë, të rinjtë vetëm e kanë atë, por më vonë "të mësuarit me anë të testeve" ngadalë e zbeh atë dukuri.

Në moshën më të hershme nënkupton që nxënësit nuk kanë frikë të fillojnë diçka të re, të eksperimentojnë me gjëra të ndryshme dhe të provojnë aktivitete të llojllojshme dhe arsimi fillor mund të luajë një rol të madh për të zhvilluar këto veçori personale dhe të inkurajohen që të përdoren në jetën e përditshme.

Arsimi fillor siguron shumë mundësi me anë të lëndëve të ndryshme mësimore në të cilat mund të inkorporohet procesi i mësimit sipërmarrës. Nxënësit mund më lehtë të inkurajohen që të mësojnë për komunitetin e tyre lokal, nevojat e komunitetit dhe problemet praktike të cilat mund dhe duhet të zgjidhen. Njoftimi i komunitetit lokal do të kërkojë që personat e rinj të prezantohen me botën me të rriturve, ku ata punojnë dhe krijojnë. Shkollat fillore janë vendi ideal ku fëmijët mund të prezantohen me botën e punës ku mund të takohen dhe të diskutojnë me njerëz që kanë okupacione të ndryshme në të cilën mund të përfshihen edhe njerëz që vetëm më kanë filluar bizneset e tyre. Kjo sigurisht mund të jetë argëtuese dhe interesante për nxënësit e rinj.

Në klasat më të larta të arsimit fillor, nxënësit mund të mësojnë për shkathtësitë që do të nevojiten për të ardhmen, si një proces i gjenerimit të ideve, vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve. Një prej qëllimeve të arsimit fillor është të prezantojë përgjegjësitë që kanë nxënësit në komunitet dhe fillimit të aktiviteteve që do të përmirësojnë pjesët e ndryshme të jetës së arsimit fillor dhe o të vije drejt nga nxënësit që do të jetë e dobishme jo vetëm për ata por gjithashtu edhe për komunitetin në përgjegjësi.

Në këtë fazë, mësimi sipërmarrës do të zhvillojë për nxënësit:

- Vetëbesimin,
- Kreativitetin,
- Shkathtësitë e punës në ekip,
- Përgjegjësi,
- Durim dhe fleksibilitet,
- Guxim për të shqyrtuar dhe eksperimentuar me gjëra të ndryshme,
- Shkathtësi të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve,
- Shkathtësi sociale,
- Shkathtësi bashkëpunimi dhe komunikimi,
- Vetëdije për komunitetin lokal,
- Shkathtësi për të përdorur lloje të ndryshme të teknologjive.

6.2 Arsimi i mesëm

Arsimi i mesëm si faza e dytë e procesit arsimor është një fushë tjetër primare për strategjinë e mësimi sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë. Arsimi i mesëm këtu do të mbulojë shkollat profesionale dhe gjimnazet.

Në këtë pjesë të zhvillimit të tyre arsimor, nxënësit do të duhet të vazhdojnë të rrisin shkathtësitë e tyre sipërmarrëse dhe duhet të fillojnë të punojnë me projekte praktike nga gjenerimi i idesë deri në zbatimin e proceseve sipërmarrëse. Ata mund të zbatojnë projektet e tyre sipërmarrëse me ndihmën e shkollës së tyre ose të shoqatave relevante dhe OJQ-të që ekzistojnë (ndërkombëtare dhe kombëtare) ose me anë të angazhimit të drejtpërdrejtë me komunitetin lokal – ku projekti do të jetë i dizajnuar për të zgjedhur një problem specifik ose nevojë për ndonjë mjedis të caktuar.

Arsimi i mesëm ka për qëllim të sigurojë nxënësit me përvojë të dorës së parë për mundësi të ndryshme të karrierës. Shkathtësitë sipërmarrëse mund të promovohen nëpër gjithë fushat e kurrikulin dhe lëndës mësimore, si dhe nëpërmjet lëndëve specifike që kanë të bëjnë me sipërmarrjen dhe inovacionin.

Mësimi sipërmarrës në këtë fazë duhet të pajis nxënësit me shkathtësitë që kanë lidhje me:

- Zhvillimin e konceptit,
- Zgjidhjen e problemeve,
- Marrjen e vendimeve,
- Krijimin e rrjeteve,
- Zbulimin e mundësive,
- Punë praktike dhe stimulim për procesin inovativ ose të kushteve të vërteta të punës,
- Njohuri për të nisur biznese,
- Njohuri ekonomike,
- Shkrim/lexim financiar,
